



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Vau Dejes, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “ Rikualifikim urban në fshatin Nënshat ”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45- Punë
ndertimore**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 9.987.172(nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e
njëqind e shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejes** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Në masën 2% të fondit limit, vlera 199.743(njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e tre)lek.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar , si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 2(dy) viteve të fundit (2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar , si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 ”*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*” (i ndryshuar).

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. (Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Vau Dejes, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 2.2.3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
ose,
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit; **(nese leshohet)**
 - Certifikaten e marrjes në dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti; (**nese leshohet**)
 - Certifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
 - Fature tatimore perkatese të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 55, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **2.996.151,6 (dy million e nenteqind e nentdhjete e gjashte mijë e e njeqind e pesedhjete e nje presje gjashte)** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël vlera limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **9.987.172(nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy)** lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur

dokumentat e kërkuara sipas pikave (2.3.2 a dhe 2.3.2 b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 54, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) Për kontratat e punëve: i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhese vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të pergjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime”

Kategoria NP-7 Niveli A “Ujësjellësi, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje”

Kategoria NP-11 Niveli A “Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.”

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-6 Niveli A “Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore, perkatesisht si me poshte;

“N.P. 1 Punime gjurmimi në tokë

*Konsiderohen **gjurmimet**, sistemimet dhe **ndryshimet në volum** të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.*

N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar **rrugët**, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të **mureve mbajtëse**, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tranvai, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, **sheshet** të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, **betonarme të thjeshtë** dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.*

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo vepre lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

N.P. 7: Ujësjellësi, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

Konsiderohen ndërtime, **mirëmbajtje ose restrukturime me ndërhyrje në rrjet** që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, **furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve**, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

Konsiderohen ndërtime, **mirëmbajtje ose restrukturime me ndërhyrje në rrjet** që janë të nevojshme për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, **të kompletuar me punimet e muraturës**, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

N.S – 8 Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri

Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të parandëruar.

Prodhimin në kantier dhe **montimin në vepër të strukturave prej çeliku** ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër.

Prodhimin në rrugë industriale dhe **montimin** në vend të strukturave të përbëra nga **elementë të drejtë** të trajtuar përpara.

N.S - 18 Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rëlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, **punime topogjeodezike në objekte inxhinierike**, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si

dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zerat e punimeve te ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi		Niveli A	1,008,810.84
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge ,autostrada,mbikalime		Niveli A	4,786,609.37
<u>Kategoria NP-7</u>	Ujësjellësi, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje		Niveli A	1,258,272.84
<u>Kategoria NP-11</u>	Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.		Niveli A	898,290.00
<u>Kategoria NS-8</u>	Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri	Shuma 7 dhe 8 e preventivit	Niveli A	987,193.61
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike		Niveli A	

Shenim: Pika e licences për punime topogjeodezike është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me infrastrukturë rrugore dhe projekti parashikon përmirësim të gjeometrisë horizontale dhe vertikale të rrugës. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në cdo fazë të zbatimit të punimeve.

2.5 Kapaciteti Teknik dhe Profesional (Burimet Njerëzore)

2.5.1 Stafi inxhinierik

a) 1 (një) inxhinier ndërtimi - drejtues teknik

Inxhinieri i ndërtimit duhet të jete i pajisur me diplome dhe duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e shoqërise si dhe të disponojë kontrate pune të vlefshme.

Pergjegjesi teknik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate me kohe pune të plote në objekt , e cila do të bashkeshoqeroje deklaratën e subjektit.

(bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020 “Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”.)

b) 1 (nje) inxhinier ndërtimi

Inxhinieri i ndërtimit duhet të jete i pajisur me kontrate pune të vlefshme dhe diplome.

Inxhinieri i ndërtimit duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se do të jete i disponueshem gjatë realizimit të kontrates.

- *Në rast se inxhinieri i kërkuar në pikën 2.5.1 germa a, nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe është i disponueshëm në kantier gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, gjë të cilën ai do ta vërtetojë me paraqitjen e deklaratës, atëherë pika 2.3.4 germa b nuk është e detyrueshme të plotësohet.*

c) 1 (nje) inxhinier topograf

Inxhinieri topograf duhet të jete i pajisur me licence profesionale dhe kontrate pune të vlefshme.

Inxhinieri topograf duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

2.5.2. Stafi i Punëtorëve të Specializuar dhe Fuqia Punëtore

Për kryerjen e punimeve, numri i punonjësve (pa përfshirë stafin inxhinierik) duhet të jetë minimalisht 6 (gjashtë) punonjës ndër te cilet të paktën 4 prej tyre duhet të figurojnë në listëpagesat e të paktën muajit të fundit, pasi 2 manovratorët mund të disponojë dhe me kontrate shërbimi. Kategorizimi i profesioneve të tyre është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (LKP)”, e ndryshuar, si më poshtë:

a) 2 (dy) Manovratorë / Operatorë të makinerive të rënda

Kodi LKP: Grupi 8342 (Operatorë të makinerive për lëvizjen e dherave - ekskavator, fadromë, makina ngjësëse) ose Grupi 8343 (Operatorë të makinerive të asfaltimit/ngritëse).

Kriteri: Duhet të paraqesin Dëshmi Aftësie Profesionale nga DPSHTRR sipas Urdhrit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.05.2019, ose dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI (ose institucione ekuivalente).

Disponueshmëria e tyre mund të provohet nëpërmjet kontratës së punës, kontratës së shërbimit, kontratës së angazhimit ose çdo dokumenti tjetër të vlefshëm që provon vënien në dispozicion të personelit për realizimin e kontratës, prandaj dhe nuk është e domosdoshme që dy manovratorët patjetër të jenë në listepagesa.

b) 1 (një) Shofer kamioni

Kodi LKP: 8332.01 (Shofer i kamionit të rëndë / mjeteve të transportit me vetëshkarkim).

Kriteri: Duhet të paraqesë leje drejtimi të vlefshme të Kategorisë C (ose më lart) nga DPSHTRR.

c) 1 (një) Elektrosaldator

Kodi LKP: 7212.01 (Elektrosaldator / Saldator me hark elektrik).

Kriteri: Duhet të paraqesë certifikatë të kualifikimit profesional si saldator, të lëshuar nga institucione të licencuara.

d) 1 (një) Betonues

Kodi LKP: Grupi 7114 (Betonues dhe të tjerë që lidhen me to).

e) 1 (nje) Punëtorë krahu (ndihmës) në ndërtim

Kodi LKP: Grupi 9312 (Punëtorë krahu në ndërtim rrugësh, digash dhe struktura të ngjashme - **Kodi specifik 9312.06**).

Specifikimi: Ky punonjës do të angazhohen si staf ndihmës në kantier. Për shkak të specifikës së projektit, duhet të ketë eksperiencë të pakten një nga keto fusha: në ndihmë të punimeve elektrike (ndriçimi i sheshit) ose në ndihmë të punimeve hidraulike (sistemimi i kanaleve dhe ujërave të shiut).

Mënyra e Vërtetimit të Kriterit për Fuqinë Punëtore:

1. Kriteri konsiderohet i përmbushur në fazën e ofertimit me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të Dokumenteve të Tenderit. Dokumentet provuese (diploma, patenta, dëshmi profesionale) do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, shoqëruar me listëpagesën përkatëse E-Sig për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit të fundit.

3. Në këtë listëpagesë, të paktën 4 punonjësit duhet të figurojnë nën kodet respektive të profesioneve sipas VKM nr. 514/2017. **Për kategorinë punëtorë krahut (kodi 9312.06),** eksperiencia specifike në punimet elektrike/hidraulike do të vlerësohet thjesht nëpërmjet CV-së ose vetëdeklarimit të përshkrimit të punës që shoqëria do të dorëzojë përpara shpalljes së fituesit.
4. Disponueshmëria e manovratoreve mund të provohet nëpërmjet kontratës së punës, kontratës së shërbimit, kontratës së angazhimit ose çdo dokumenti tjetër të vlefshëm që provon vënien në dispozicion të personelit për realizimin e kontratës, prandaj dhe nuk është e domosdoshme që dy manovratorët patjetër të jenë në listëpagesa.

Argumentimi Teknik dhe Ligjor i Kriterit:

- **Përlllogaritja e stafit:** Numri i punonjësve dhe stafit inxhinierik është përcaktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës, afatit, orëve të punës dhe volumit përkatës të çdo zëri në preventiv dhe grafikut të zbatimit të punimeve (pjesë e dosjes së projekt-zbatimit të hartuar nga shoqëria **“LENI-ING” shpk**). Punimet duhet të përfundojnë brenda **4 muajve kalendarikë** nga data e nënshkrimit të kontratës, mbështetur kjo në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”.
- **Baza Ligjore:** Kërkesa është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; Nenin 39, pika 6, gërma (c), gërma (ç) dhe pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.
- **Arsyetimi për Inxhinierët:** Inxhinieri i Ndërtimit (Drejtuesi Teknik) është përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës sipas projektit, kushteve teknike, specifikimeve, sigurimit teknik dhe hartimit të projektit As-Built e atij të mirëmbajtjes. Ndarja e kërkesës në dy inxhinierë (Drejtues Teknik dhe Përgjegjës Kantieri) është bërë me qëllim që të mos penalizohen apo kufizohen ato shoqëri që drejtuesit teknikë i kanë të angazhuar në kontrata të tjera aktive. Inxhinieri i topografisë është i domosdoshëm për matjet topografike, nxjerrjen e kuotave të gërmimit, shtresave rrugore dhe sistemimin e kanaleve anësore.
- **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit:** Kërkesa që punonjësit e specializuar të disponojnë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik dhe drejtimit të mjeteve bazohet në detyrimin e operatorëve për zbatimin e masave të mbrojtjes në punë, si dhe në Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.05.2019.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur për cdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve si më poshtë

3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm	m2	501.0								
	Sp+p	op		40.08				5.01	30	0.17	
3.7	Shkulje rrenjeve bimeve te vogla	m2	246.0								
	Sp+p	op		49.20				6.15	30	0.21	
3.643	Mbjellje bari ne skarpat	m2	507.0								
	Fere bari	kg					25.4		30	0.85	
	Dhe' vegjetal	m3					50.7		30	1.69	
	Sp+p	op		86.19				10.77	30	0.36	
3.966	F.V. Mbjellje peme dekorative Bli 16-18cm ne trotuar, (cdo 6m)	cope	14.0								
	Peme dekorative Bli 16-18 ne trotuar (cdo 6m)	cope					14.0		30	0.47	
	Sp+p	op		14.00				1.75	30	0.06	
3.87/b	Germim dheu me ekskavator goma, 0.25 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke	m3	429.0								
	Ekskavator 0.25 m3	op				36.47		4.56	30	0.15	
3.17/a	Germime dheu ne seksion te lire me krahe,ne toke te bute,kateg.I-II, trans.karro dore deri 10 m	m3	40.0								
	Sp+p	op		248.00				4.56	30	0.15	
3.46/1	Germim kanalesh ne toke te forte, me krahe, me seksion deri 0.75 m²	m3	33.0								
	Punetori e thjeshte (paga bruto +kontributet)	op		232.65				29.08	30	0.97	
